



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:016598  
Datë: 15.04.2024  
Numri i dokumentit: 05575305

**C-IV-14-7756**

**15.04.2024**

*Ankuesi*

**A P–Gjakovë.**

Kundër

*E paditura*

**Agjencia Kosovare e Privatizimit - Rr “Dritan Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.**

Palët ndërgjyqëse:

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Murat Hulaj, pas vlerësimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, jashtë seancës me datë 15 prill 2024 bie këtë:

**A K T V E N D I M**

**Konform nenit 34 par.1 dhe 3 të Ligjit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, Ligji Nr.06/L-086**

- I.** Gjykata jep pëlqimin për tërheqjen padisë së paditësve, ashtu që padia e paditësit,  
**KONSTATOHET e tërhequr.**
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me datë 12.02.2014, ankuesi parashtrij ankesë kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit **PEJ150-0081** të datës **06.01.2014** me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim për paga të papaguara, në shumë prej 1,320.00 Euro nga N.SH “Modeli” (në likuidim).

Me 26.02.2024, gjykata lëshoj për përfaqësuesin e ankuesit Av. T B vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Me datë 06.03.2024 përfaqësuesi i ankuesit ka njoftuar gjykatën me një parashtrise me të cilën njofton se nuk e përfaqëson më palën dhe që heq dorë nga përfaqësimi i tij.

Me datë 08.03.2024, gjykata lëshoj për ankuesin A P për herë të dytë vërejtje për ta paguar taksën gjyqësore, duke e njoftuar ankuesin se nëse taksa nuk paguhet brenda periudhës së caktuar prej 15 ditësh, ankesa do të konsiderohet e tërhequr.

Me datë 23 mars 2024, ankuesi i është drejtuar gjykatës me parashtrise me të cilën kërkon tërheqjen e padisë.

## **Arsyetimi ligjor**

### **Dhoma e Posaçme jep pëlqimin për tërheqjen e padisë .**

Neni 2.4 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 par.1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji

Në nenin 34 të Ligjit Nr.06/L-086 Për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, parashihet se: “ *Paditësi mund ta tërheqë kërkesën apo ankesën e tij në çdo kohë me pajtimin e Dhomës së Posaçme. Me dhënien e pëlqimit të tillë, Dhoma e Posaçme merr parasysh interesin e të gjitha palëve të tjera. Vendimi për dhënien e pëlqimit për tërheqje mund të përfshijë urdhërpagesën për shpenzimet e procedurës nga pala që tërhiqet. Vendimi i tillë nuk e ndalon palën nga parashtrimi i serishëm i kërkesës apo ankesës*”. Në rastin konkret, paditësi me parashtrisen e dt. 23 mars 2024, i ka propozuar kësaj gjykate tërheqjen nga padia.

Vendimin për dhënien e pëlqimit për tërheqjen e padisë së paditësit, gjyqtari e mori në përputhje me nenin 34 par.1 dhe **3 të Ligjit të Dhomës se Posaçme te Gjykatës Supreme të Kosovës, Ligji Nr.06/L-08** ngas nuk është në kundërshtim me interesin e ndonjërës palë.

Me 23 mars 2024, paditësi personalisht A Rr ka paraqitur parashtrisë me shkrimë përmes te secilës e ka njoftuar Gjykatën(DHPGJS) për tërheqje të padisë kundër të paditurave Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Komuna e Gjakovës dhe NSH “Modeli “-Gjakovë

Për detaje tjera referim behet tek dosja e lëndës.

## **Shpenzimet Gjyqësore**

Në pajtim me nenin 62.5 të Ligjit të Dhomës së Posaçme (Ligji nr. 06/L-086), secila palë i bart shpenzimet e veta.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,  
*Murat Hulaj,*